

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 227, datë 25.11.2022

MBI BASHKËPUNIMIN E STRUKTURAVE TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME DHE MINISTRISË SË BRENDSHME PËR PROCEDURAT E PAJISJES ME FTESË PARAPRAKE PËR TË HUAJT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 17, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me qëllim harmonizimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për përcaktimin e procedurave për marrjen e vendimit për pajisjen me ftesë për të huajt që hyjnë pa vizë, si dhe formatin dhe përmbajtjen e ftesës së të huajt në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJMË:

I. INSTITUCIONET DHE PROCEDURA E MARRJES SË VENDIMIT PËR PAJISJEN ME FTESË PËR TË HUAJT QË HYJNË PA VIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse që bashkëpunojnë për procedurën e pajisjes me ftesë, janë:

a) në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më poshtë MEPJ) – Drejtoria e Çështjeve Konsullore (më poshtë “DÇK”) dhe Përfaqësia Diplomatike Konsullore (më poshtë “PDK”) të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit;

b) në Ministrinë e Brendshme (më poshtë “MB”) – Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Policisë së Shtetit (më poshtë “DKM”);

2. Me propozim të njërit prej autoriteteve përgjegjëse të përcaktuar në pikën 1, të këtij udhëzimi, në bazë të analizës së riskut së bërë nga autoriteti propozues, si dhe në interes të parandalimit të migracionit të paligjshëm, DKM-ja pas konsultimit me MEPJ-në merr vendimin për përcaktimin e një liste me shtetet, shtetasit e të cilëve duhet të pajisjen me ftesë përpara hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur shtetësia e tyre vlerësohet me risk për një periudhë të caktuar.

3. Vendimi i marrë për listën e shteteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij udhëzimi, dërgohet zyrtarisht pranë MEPJ-së, autoriteteve përgjegjëse vendore të kufirit dhe migracionit në pikat e kalimit kufitar dhe autoriteteve përgjegjëse për trajtimin e të huajve në territor.

4. Lista e shteteve publikohet në faqet zyrtare të institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të këtij udhëzimi, u bëhet e njohur përfaqësive të posteve konsullore shqiptare, si dhe autoriteteve shtetërore të vendeve pjesë e kësaj liste.

5. Ftuesi i dërgon një kopje të ftesës të huajt, si dhe depoziton fizikisht një kopje të saj, pranë autoritetit vendor përgjegjës për kufirin dhe migracionin ku ka vendbanimin apo vendqëndrimin.

II. FORMA DHE PËRMBAJTJA E FTESËS

1. Forma dhe përmbajtja e ftesës për të huajt që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të pikës 2 dhe pikës 4, të nenit 17, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, është sipas aneksit nr. 1.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Bledar Çuçi

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Olta Xhaçka

ANEKSI NR. 1

FTESË

Unë i nënshkruari/a _____, lindur më datë _____, në
(rrethi i lindjes) _____, me shtetësi _____, banues/e në adresën
Rruga: _____, Nr. _____ Shk./Ap. _____ Rrethi _____, me punë (funksioni)
_____ Emri i Kompanisë/Institucionit _____, në
Adresën Rruga: _____, Nr. _____ Shk./Ap. _____ Rrethi _____, nr. kontakti shqiptar
(celular/zyrë) _____ me dokument identifikimi _____, i
ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e parashikuara në nenin 17 dhe nenin 141 të ligjit nr. 79/2021
“Për të huajt”:

Deklaroj:

Se ftoj në Shqipëri shtetasin/it:

- 1) _____ i/e lindur më datë _____ në _____, me
shtetësi _____, mbajtës i pasaportës me nr. Serie: _____ dhe
vlefshmëri deri më datë _____;
- 2) _____;
- 3) _____;

Lidhja me të ftuarin/it _____;
(e) të cili/a/ët dëshiron/jnë të vijë/në në Shqipëri nga data: _____ deri më
datën _____, për motiv/e _____.

Gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri garantoj se:

- a) do t'i sigurojë të huajt/ve sistemimin dhe vendqëndrimin gjatë kohës së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;
- b) të mbulojë koston e kujdesit shëndetësor dhe largimin;
- c) të shpërblejë të tretët nga dëmet që u kanë ardhur për mospërmbushje të detyrimeve të marra përsipër në ftesë;
- ç) do të mbulojë shpenzimet e kthimit në vendin e destinacionit, në rast se për të huajin është nxjerrë një urdhër largimi, largimi me forcë ose dëbimi dhe ky nuk ka mjete financiare;

Gjithashtu, jam njohur me pasojat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të sipërpërmendura.

Shënim: Nëse ftuesi është shtetas shqiptar i bashkëngjit kësaj ftese fotokopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportës/letërnjoftimit). Nëse ftuesi është i huaj i bashkëngjit fotokopjen lejes së vlefshme të qëndrimit.

DEKLARUESI / FTUESI

emri, mbiemri /nënshkrimi